



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

# KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## UE QENDRA E KUVENDIT

### UE LAJME

qershor 2017

EUQ - numër 25/2016



## REZOLUTË E MIRATUAR E PARLAMENTIT EVROPIAN PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Parlamenti Evropian në sesionin plenar në 14 qershor këtë vit e miratoi Rezolutën për Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, me 503 vota "për", 113 vota "kundër" dhe 45 "të përmbajtur".

Maqedonia meriton të jetë anëtare e UE-së dhe NATO-së".

Rezoluta e cila ishte e parashtruar nga referuesi në PE për Republikën e Maqedonisë eurodeputeti sloven Ivo Vajll, paraprakisht është shqyrtuar dhe miratuar në Komitetin për politikë të jashtme (AFET) në 28 shkurt këtë vit me 54 vota "për" dhe 8 "kundër". Para votimit në Komitet, në tekstin e Propozim-rezolutës, eurodeputetët harmonizuan 28 amendamente të kompromisi, në lidhje me gjithsej 318 amendamentet të parashtruar.

Në Debat eurodeputeti Tonino Piculla referues nën hije për Maqedoninë, në emër të socialistëve dhe demokratëve, e përshëndeti formimin e qeverisë së re pas sigurimit të shumicës në Parlament, dhe e theksoi këtë "Bregosem se procesi i ndarjes së mandatit zgjate jashtëzakonisht gjatë dhe erdhi në incidente të dhunshëm në Kuvend. Shpreson se partitë politike do t'i vënë dallimet e tyre anësh dhe se do të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive për të mirën e qytetarëve të Maqedonisë dhe ardhmërinë e tyre evropiane të cilën e meritojnë".

Europarlamenti e përshëndeti formimin e qeverisë së re dhe e ftoi së bashku me të gjitha partitë politike në shtet ta kthejë besimin në vend dhe institucionet, të miratojë dhe plotësisht të zbatojë reforma të forta në sferën e sundimit të drejtësisë, jurisprudencës, luftës kundër korrupsionit, të drejtat fundamentale, punët të brendshme dhe marrëdhëniet të mira fqinjësore. Pasi që të arrihet përparimi në zbatimin e Marrëveshjes nga Przhinoja nga viti 2015 dhe përparimi në reformat, PE do të japë përkrahje për hapjen e bisedimeve për aderim në UE.

Në Rezolutën e miratuar përshëndetet respektimi i lirive fundamentale gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11.12.2016, të cilat ishin mirë të zbatuara, të realizuara në mënyrë transparente dhe inkluzive dhe pa incidente më të mëdha.

Me rezolutën ftohen të gjitha palët të përmbahen nga çfarëdo qoftë pengesa për funksionim efikas të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Në debatin eurodeputeteja Marijana Petir shtjelloi "Unioni Evropian i porositi Maqedonisë se doemos duhet të zgjedhë problemin me Greqinë për emrin, që të hapet dera e UE-së dhe NATO-së. Qasjen e tillë të UE-së e konsiderojë për të papranueshme sepse u bë plotësisht e qartë se UE ka kritere të dyfishta kur bëhet fjalë për zgjerim dhe se nuk ka aspak mundësi t'i bëjë presion Greqisë ta ndryshojë qëndrimin rreth emrit...

Rezoluta noton se është e rëndësishme të zbatohet regjistrim i popullatës me kushte të ekzistojë konsensus i gjerë për metodologjinë e cila do të zbatohet. Është e nevojshme edhe mëtejme të azhurnohet Lisa zgjedhore dhe të minimizohen çfarëdo qoftë parregullsi dhe mangësi në të ardhme.

### Përmbajtja e lajmeve:

Rezolutë e miratuar e PE-së për Republikën e Maqedonisë	1-2
Në fokus të Parlamentit Evropian	3
Aktivitete kuvendare të lidhura me çështjet evropiane	4-5
PE propozon përforsim të sigurisë të përbashkët të UE-së	6
Është shënuar 30 vite nga programi evropian—Erazmus +	7
Rregulla të reja për e-privatësi	8
Ditë evropiane të zhvillimit 2017	9
Filluan bisedimet për "Bregzit"	10
Takim i këshillit evropian	11
Unioni Evropian i anuloi shpenzimet për roaming	12
Është nënshkruar Konventa e Stambollit për luftë kundër dhunës ndaj grave	13
UE kalendar / korrik /2017	13

## REZOLUTË E MIRATUAR E PE-SË PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Në lidhje me vitin 2016, eurodeputetët shprehën brengosje për ngecjen e vazhdueshme në reformën në jurisprudencë. Dënohet përzierja e politikës në punën e gjyqësisë, duke përfshirë edhe në emërimin dhe avancimin e gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe mungesa e përgjegjësisë dhe ekzistimi i drejtësisë selektive. Sugjerohet në rëndësinë e mandatit dhe punën e Prokurorit special publik dhe Komisionit parlamentar për hetime, që të përcaktohet edhe përgjegjësi juridike dhe politike. PE shpreh brengosje për sulmet politike, obstrukcioneve administrative dhe gjyqësore në punën e Prokurorisë speciale publike, si dhe për mungesën e bashkëpunimit me institucionet tjera. Parlamenti ftoi të jepet përkrahje e plotë e Prokurorisë speciale publike, të jepen kushte adekuate dhe kohë për punë të papenguar të të njëjtës.

Në Rezolutën shprehet brengosje se korrupsioni vazhdon të paraqes problem serioz dhe se lufta kundër korrupsionit gërmohet nga ndikimi politik. UE e theksoi nevojën të përforcohet pavarësia e policisë, prokurorinë dhe Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit.

Rezoluta e përsërit rëndësinë nga mediet të lira dhe të pavarura, si një nga vlerat kryesore të UE-së dhe themel i çdo demokracie.

Përshëndeten rezultatet e dukshme nga iniciativa për masat për ndërtim të besimi ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, e cila mund të kontribuojë në kuptimin e mirë dhe



marrëdhënie më të forta bilaterale, duke e hapur rrugën për gjetje të zgjedhjes së përbashkët të pranueshme për çështjen për emrin.

Rezoluta fton të gjitha partitë politike dhe organizatat qytetare në mënyrë aktive të promovojnë shoqëri inkluzive dhe tolerante multietnike dhe multikulturore. Gjykohet çfarëdo qoftë forme e iredentizmi dhe çdo përpjekje për dezintegrim të grupeve të ndryshme sociale.

Parlamenti Evropian e përshëndeti mbajtjen e stabilitetit makroekonomik, zvogëlimin e shkallës së papunësisë dhe përkushtimin e vazhdueshëm të Qeverisë për nxitje të rritjes ekonomike dhe punësim nëpërmjet politikës ekonomike tregtare. Në të njëjtë kohë PE shprehi brengosje për qëndrueshmëri të borxhit publik dhe faktin se papunësia mbetet e lartë me pjesëmarrje shumë të ulët të tregut të punës, veçanërisht ndërmjet të rinjve, grave dhe personat me nevoja të veçanta.

Rezoluta e thekson rëndësinë nga dialogu i rregullt dhe konstruktiv dhe bashkëpunim me organizatat të shoqërisë qytetare.

Parlamenti Evropian i urojë Republikës së Maqedonisë për rolin konstruktiv, si dhe për përpjekjet e mëdha të cilat i bëri në zgjedhjen e sfidave nga kriza me migrimin, me çka dukshëm kontribuoi për sigurinë dhe stabilitetin e UE-së.

<http://www.europarl.europa.eu>

## NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

### Sesion plenar 12-16 korrik 2017

Në sesionin plenar të Parlamentit Evropian eurodeputetët debatonin për zbatimin e Fondit Evropian për inovacione strategjike (EFSI), me ç'rast kërkuan baraspeshë më të madhe gjeografike, përkrahje për kompanitë më të vogla dhe investime më inovative.

Eurodeputetët sugjeruan në ekzistimin e shpërndarjes të pabarabartë të sektorëve. Projekteve energjetike u bien 46% nga financimi i përgjithshëm i fondit, ndërsa te infrastruktura sociale, shëndetësi dhe arsim janë përfaqësuar vetëm 4% nga mjetet dhe të njëjtat janë të pamjaftueshme. Eurodeputetët kërkuan të futet prag prej 30% të EFSI për çdo sektor konkret.

Europarlamenti debatonte për dekretin e ri e cila hyn në fuqi në vitin 2019, sipas së cilës të gjitha aparatet për amvisëri do të shënohen me shenjë për efikasitet energjetik prej A deri në G. Konsumatorëve do t'u mundësohen informata të qarta për prodhimet dhe përzgjedhje individuale të prodhimeve me të cilat do të mund të kursejnë në konsumimin e energjisë elektrike.

Eurodeputetët në seancën plenare debatonin për raportet të Komisionit Evropian për vitin 2016 për Republikën e Maqedonisë, Serbisë dhe Kosovës.

Në lidhje me përgatitjet për takimin e Këshillit Evropian për 22-23 qershor këtë vit, eurodeputetët me kryetarin e Komisionit Evropian dhe kryetari i Malltës me UE-në debatonin për migrimin, sigurinë dhe mbrojtjen.

Pas debatit për tërheqjen e paralajmëruar të SHBA-ve nga Marrëveshja për ndryshime klimatike, eurodeputetët e përkrahën planin për zvogëlim të emetimeve të gazrave qelqor, me të cilin pritet të arrihet qëllimi i përgjithshëm i UE-së për vitin 2030 - zvogëlim për 40% në krahasim me nivelin e vitit 1990. Që të sigurohet parashikim afatgjatë, eurodeputetët, gjithashtu vendosën qëllim për vitin 2050 - zvogëlim të

emetimeve të gazrave qelqor për 80% në krahasim me nivelet nga viti 2005. Eurodeputetët debatonin me kryetarin e Ishujve Marshale, Hilda Hajne dhe kryetarin e Komisionit Zhan-Klud Junker për paralajmërimin e kryetarit Donald Tramp, SHBA të tërhiqet nga Marrëveshja nga Parisi. Kryetari i PE, Antonio Tajani deklaroi se vendimi i administratës amerikane është gabim. Duke punuar së bashku me popujt përtej botës mund me sukses të sigurohet planet më i pastër dhe më i sigurt për qytetarët.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të ligjit me të cilin anulohen roaming shpenzimet për bisedime telefonike në UE, në sesionin plenar të PE u drejtua kryetari Antonio Tajani.

PE miratoi listë të vendeve të cilat do të jenë kryeqendra evropiane të kultursë në periudhën 2020-2033. Çdo vit dy vende-anëtare zgjedhin qytet i cili do të jetë nikoqir i iniciativës Kryeqendra evropiane e kulturës, ndërsa për herë të parë, vendet të EFTA/EEA mund të marrin pjesë në këtë program një herë në çdo tre vjet. Iniciativa ka për qëllim të mbrohen dhe promovohen pasuria dhe llojllojshmëria e kulturave dhe ta nxit pjesëmarrjen e qytetarëve për përkatësi ndaj ndonjë sferë të përbashkët të kulturës. Qyteti i Rjekës do të jetë kryeqendra evropiane e kulturës në vitin 2020.

Eurodeputetët debatonin për politikën kohezive të UE-së pas viti 2020, me ç'rast theksuan se politika e përhershme kohezive e zbut ndikimin e krizës ekonomike dhe masat për kursim, por dallimet regjionale dhe sociale mbetet të larta. Eurodeputetët ftuan në aktivitete të konsoliduara pas vitit 2020, buxhet adekuat, sinergji më të mirë, thjeshtëzim të sistemit për menaxhim me politikën.

<http://www.europarl.europa.eu/news/en>



## AKTIVITETE KUVENDARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë z. Talat Xhaferi merte pjesë dhe kishte fjalim të tij në Forumin e tetë parlamentar ndërkombëtar të sigurisë i cili u mbajt më 19 qershor në Riga. Në korniza të pjesëmarrjes të 8-të. Forumit ndërkombëtar të sigurisë, kryetari i Kuvendit realizojë edhe takim oficial me z-nj. Inara Murniece, spikere e Parlamentit të Republikës së Lituanisë. Bashkëbiseduesit ndanë besime të dnënjella dhe pritje se bashkëpunimi bilateral fortë i vendosur ndërmjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Parlamentit të Republikës së Lituanisë në nivel të grupeve parlamentare për bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhme me tempo të pazvogëluar, me çka deputetët nga të dy parlamentet do të kenë mundësi prej së afërmi të këmbëjnë mendime dhe përvoja nga puna parlamentare, politika ndërkombëtare dhe çështje tjera aktuale.

Kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi realizoi takim edhe me z. Robert Pitinxher, kongresmen amerikan dhe kryetar i Grupit punues të kongresit për terrorizëm dhe luftë jokonvencionale dhe iniciues i këtij forumi. Në takim ishin këmbyer pikëpamje për pyetje të lidhura me sigurinë e regionit, luftës kundër terrorizimit dhe sajber-krimin, dhe nevojës nga strategjia e sajber-mbrojtjes.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi më 27 qershor 2017 realizojë takim me drejtoreshën e Drejtorisë për zgjerim të Komisionit Evropian, kompetente për Ballkanin Perëndimor, z-nj. Genoveva Ruiz Kallavera. Gjatë kohës së takimit, bashkëbiseduesit ishin në pajtim se realizohet shpejtësia e realizuar e aktiviteteve të lidhura me funksionim efektiv dhe efikas të Kuvendit në realizimin e kompetencave të veta si shtëpi ligjvënëse.

Kryetari Xhaferi edhe një herë potencoi se Kuvendi mbetet i hapur për qytetarët dhe sektorin qytetar duke u angazhuar gjatë asaj për ndryshim të perceptimit të deritashëm për Kuvendin dhe e njëjta të mbetet korrigjues i vërtetë i pushtetit ekzekutiv.

## AKTIVITETE KUVENDARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Kryetari i Komisionit për çështje evropiane, deputeti Artan Grubi, më 22 qershor këtë vit në Kuvend kishte takim me euroambasadorin Samuel Zhbogar. Në takim bashkëbiseduesit biseduan rreth sfidat të reformave për Maqedoninë në pajtim me pritjet të Brukselit, UE-së dhe NATO-së, sfidat të Komisionit për çështje evropiane në lidhje me shpejtësinë ambicioze të agjendës së re reformuese me përkushtimin për integrim të vendit në NATO dhe UE. Deputeti Grubi theksoi se është në pritje të miratimit të Udhërrëfyesit nga ana e Qeverisë, ndërsa e nënvizoi edhe nevojën për miratim të një rezolutë gjithëpërfshirëse nga ana e Kuvendit për përkrahje të reformave dhe integrimin në UE.

ambasadori i UE-së në Republikën e Maqedonisë Samuell Zhbogar dhe zëvendës kryetari i Qeverisë i angazhuar për çështje evropiane Bujar Osmani. Në debatin e Komisionit morën pjesë deputetët: Frosina Remenski, Antonio Milloshoski dhe Zekirija Ibrahim, të cilët në prononcimet e tyre i përkrahën proceset evropiane të Republikës së Maqedonisë, me ç'rast ishin shprehur përgatitje vendi të investojë përpjekje për zbatimin e UE reformave të domosdoshme, me qëllim të afrohemi më afër UE-së. Në propozim të kryetarit Grubi, Komisioni miratoi konkluzion Kuvendi të miratojë deklaratë për përshejtim të proceseve reformuese dhe integruese për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në UE.



Komisioni për çështje evropiane më 28 qershor 2017 e mbajti Mbledhjen e parë të përkushtuar proceseve eurointegruese të vendit, në të cilën ishin këmbyer mendime dhe qëndrime për avancimin tyre, nga aspekti parlamentar. Fjalime hyrëse kishin kryetari i Komisionit Artan Grubi,



Delegacioni i Kuvendit në përbërje të: Betiane Kitev, Shpresa Hadri, Ilija Dimovski dhe Afrim Gashi, më 19 dhe 20 qershor 2017, morën pjesë në Konferencën interparlamentare në temë: "UE proces ligjdhënës - nga iniciativa ligjvënëse deri te implementimi dhe monitorimi", në organizim të Parlamentit Evropian, e cila u mbajt në Bruksel. Deputetët në Konferencën i prezantonin praktikën politike dhe juridike në vendin tonë, nga aspekti parlamentar, në lidhje me procesin ligjvënës, ndërsa në drejtim të avancimit të procesit eurointegruese.

## PARLAMENTI EVROPIAN PROPOZON PËRFORCIM TË SIGURISË TË PËRBASHKËT TË UE-SË



Sipas hulumtimit Evrobarometër nga marsi i këtij viti, 68% të qytetarëve evropian konsiderojnë se UE duhet më shumë të investojë në sigurinë dhe koordinimin e policisë dhe ushtrisë. Parlamenti Evropian gjithashtu angazhohet për bashkëpunim më të madh në mbrojtje si dhe për integrim të masave të caktuara të mbrojtjes. Eurodeputetët paraprakisht i nxitën vendet-anëtare t'i zmadhojnë investimet në mbrojtje deri në 2% të BPV-së.

Unioni Evropian është shpenzuesi i dytë më i madh në botë në fushën e mbrojtjes. Në vitin 2016 SHBA ka shpenzuar 546 miliardë euro, ndërsa 28 vende anëtare të UE-së kanë shpenzuar 206 miliardë euro. Industria në fushën e mbrojtjes në vit realizon 100 miliardë euro dhe punëson 1,4 milionë njerëz me çka realizon kontribut të rëndësishëm në ekonomi. Sipas vlerësimit, UE në vit shpenzon 26,4 miliardë euro për shkak të dyfishimit të shpenzimeve dhe barriera të caktuara në furnizimet publike në mbrojtje.

Në Rezolutën e UE-së për Unionin evropian të mbrojtjes e miratuar më 22.11.2016 Parlamenti kërkoi investim të përbashkët me qëllim zvogëlim të çmimeve të larta të furnizimeve në mbrojtje, si dhe themelimit të forcave multinacionale dhe një qendër të nivelit të UE-së nëpërmjet të cilit më lehtë do të planifikohen edhe drejtohen operacionet.

Eurodeputetët kërkuan zmadhim të financimit të Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes, shfrytëzim të bashkëpunimit ekzistues strukturor dhe përfshirje të plotë në bashkëpunimin e forcave ushtarake të UE-së. Që të sigurohet efikasiteti i shpenzimit në mbrojtje, Komisioni Evropian propozoi Plan evropian aksionar për mbrojtje dhe Fond Evropian për mbrojtje.

Në UE ekzistojnë sisteme të ndryshme të

armatimit, për shkak të të cilës interoperabiliteti i përbërjes ndërmjet vende-anëtare të ndryshme është pikë e dobët e cila duhet të zgjidhet në të ardhme. Ekspertët propozojnë, ministrat të mbrojtjes të UE-së të takohen në këshill të veçantë me qëllim më mirë të sinkronizohet planifikimi dhe të zbatohet revizioni vjetor i koordinimit të mbrojtjes.

Ndryshimet gjeopolitike në fqinjësinë e UE-së, terrorizmi, mashtrimet kompjuterike dhe pasiguria energjetike, tregojnë se vendet-anëtare individualisht nuk mund të përgjigjen në sfidat. Vendet-anëtare do të duhet të tregojnë vullnet politik, t'i zmadhojnë investimet, të ndajnë informata dhe të krijojnë sinerji në nivel të UE-së, që të sigurojnë mbrojtje më të mirë të qytetarëve.

Në lidhje me të ardhmen e mbrojtjes evropiane, Parlamenti Evropian e theksoi nevojën për vlerësim të ardhëm të marrëdhënieve ndërmjet UE dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Në lidhje me bisedimet për Bregzit, pozita e PE-së e miratuar në 6 prill këtë vit, është se nuk ka tregtim me parimet të sigurisë.

<http://www.europarl.europa.eu>



## ËSHTË SHËNUAR 30 VITE NGA PROGRAMI EVROPIAN — ERAZMUS +

Programi erasmus (European Region Action Scheme for the Mobility of University Students) paraqet platformë për mobilitet evropian dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunim e cila i bashkon njerëzit nga mjedise të ndryshme dhe mundëson të fitojnë kompetenca si dhe të zhvillojnë ndjenjë të identiteti evropian - i cili i plotëson identitetet kombëtare, regjional dhe lokale.

Në 30 vitet e kaluara nga zbatimi i Erasmus, mbi 3 milionë studentë evropian një pjesë e studimeve i kaluan në universitete ose organizata në pjesë të ndryshme të Evropës.

Programi Erasmus ishte përpiluar si këmbim provë i studentëve nga viti 1981 deri në vitin 1986, ndërsa oficialisht ishte i miratuar më 17 qershor 1986. Në vitin e parë të programit qenkan të përfshirë 11 vende-anëtare dhe 3.244 studentë.

Programi nga viti 1987 ishte i drejtuar kah studentët në arsimin e lartë. Prej atëherë programi është zhvilluar dhe ofron mundësi në sferën e arsimit profesional, arsimin shkollor, arsimin e të moshuarve, të rinjve dhe sportit.

Programi Erasmus Plus ishte futur në vitin 2014 me bashkimin e një programi të të gjitha iniciativave të atëhershme në sferën e arsimit, të rinjve dhe sportit (Erasmus, Leonardo da Vinçi, Komenius, Grundtvig, Zhan Mone, Alfa, Edulink dhe Sport). Në programin e ardhshëm janë përfshirë stazhimi në vendin e punës, aktivitete për aftësim profesional dhe arsimim, projekte për bashkëpunim ndërmjet universiteteve, organizatat hulumtuese, ndërmarrjet, organizata joqeveritare, trupa lokal, regjional dhe kombëtar në Evropë.

Buxheti i Erasmus Plus për vitin 2014-

2020 është 14.7 miliardë euro me të cilat më shumë se 4 qytetarë evropianë do të kenë mundësi për studim jashtë vendit, përsosje profesionale, volontim dhe fitim të përvojës.

Me programin menaxhojnë: Komisioni evropian, Agjencia ekzekutive për arsim dhe politikë audiovizuale dhe kulturë, agjencitë kombëtare në vendet pjesëmarrëse në programin dhe trupa kombëtar në vendet partnere.

Tridhjetë vjetori i Erasmus përputhet edhe me një lëvizje të integritimeve evropiane - 60 vjetori i Marrëveshjes së Romës, me të cilën promovohet Union më i afërt për bashkëpunim në korniza të Evropës.

Me të dy jubiletë u shënuar qëllimi i përbashkët - bashkimi i evropianëve. Gjatë vitit 2017 për programin Erasmus, në Evropë do të organizohen ngjarje, konferenca, forume, debate, ekspozita në nivele lokale, kombëtare dhe në nivele evropiane.

Republika e Maqedonisë u bashkëngjiti në programin Erasmus Plus në qershor të vitit 2014.

<https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus>



## RREGULLA TË REJA PËR E-PRIVATËSI



Me rregullatinë e re për e-privatësi do të ndryshohet mënyra e mbrojtjes të të dhënave në internet, duke filluar nga mënyra në të cilën ueb pastat (cookies) i përcjellin aktivitetet tona në internet.

Informatat ruhen nga ana e ueb-sajteve në formë të pasta, të cilat mund t'i pranojmë ose refuzojmë nëpërmjet pop-up dritareve e cila paraqitet kur vizitohet një ueb-sajt i ri. Në janar të këtij viti Komisioni Evropian propozojë rregullativë të re për e-privatësi, e cila mund ta ndryshojë këtë procedurë, në dobi të vendosjes të parametrave në pajisjet tona ose internet shfletuesit që të shmangët detyrim për ballafaqim të përhershëm me pop-up dritaret. Para se të hynë në fuqi rregulla të reja, do të duhet të lejohen nga Parlamenti Evropian. Eurodeputetët pritet të votojnë për propozimin e sesionin plenar në tetor të këtij viti.

Direktiva origjinale është miratuar në vitin 2002, dhe prej atëherë ka ndryshime të rëndësishme në mënyrën e këmbimit të informatave në internet. Informatat më pakë këmbehen nëpërmjet telefonave celular dhe postës elektronike. Këmbimi i informatave sot zhvillohet nëpërmjet të gjitha llojet të medieve sociale: Instagram, WhatsApp, Messenger etj. Këto vegla dhe kanale nuk ishin të përfshira me direktivat paraprake.

Planifikohet ligjvënja të zbatohet në të gjitha vendet-anëtare të UE-së në mënyrë të ngjashme, pritet edhe mbrojtja të jetë në nivel të njëjtë.

Procedura për pranim ose refuzim të pastave (cookies) në ueb-faqet do të zhvillohet në mënyrë që shfletuesi, internet faja ose celulari inteligjent do të ketë opsion të veçantë (të pranojë pasta). Për shembull kur dikush dëshiron të përcjell lokacioni i tij sepse dëshiron ta

dijë atë në rast të humbjes së telefonit, ose dëshiron të shfrytëzojë Uber zgjidhet opsioni për dërgim të lokacionit. Çdokush duhet të jetë i sigurt se mjedisi privat është nën kontroll personal, ndërsa jo nën kontroll të ndonjë tjetri.

Programet dhe dhënësit të shërbimeve do të jenë të obliguar të japin informata në mënyrë të mjaftueshme të kuptimita dhe të thjeshta.

Përzgjedhja për konsumatorët duhet të bëhet gradualisht, ashtu që do të ketë sa më shumë dhe më shumë interaksion ndërmjet dhënësit të shërbimeve dhe klientit.

Rregullat të reja do t'u japin përparësi konkrete industrive evropiane. Njerëz të rinj nga më shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme tashmë punojnë në këtë lloj të zgjidhjeve inovative dhe mënyrën si të mbrohet privatësia e konsumatorëve.

Botuesit evropian shprehën brengosje në lidhje me ndryshimin e rregullave për pasta, duke pohuar se ajo do t'u japë më shumë forcë internet gjigantëve të cilit i kontrollojnë kërkuesit dhe vendin ku është dhënë leja për përdorim të të dhënave.

Për zgjedhjen e kësaj çështje të konsumatorëve u janë ofruar nivele të ndryshme të përzgjedhjes. Ajo që duhet të arrihet është të zbatohet përdorim standarde „no tracking“.

Kompanitë evropiane do të duhet të komunikojnë në mënyrë më aktive për ofertat e tyre me ç'rast konsumatorët do të mund të bëjnë përzgjedhje të vërtetë.

<http://www.europarl.europa.eu>



## DITËT EVROPIANE TË ZHVILLIMIT 2017

Unioni Evropian dhe vendet-anëtare në 7 qershor këtë vit nënshkruan plan strategjik në të cilin theksohet ardhmëria e politikës evropiane të zhvillimit.

Ky "Konsensus i ri Evropian për zhvillim" paraqet vizionin e ri kolektiv dhe planin për aksion për zhdukjen e varfërisë dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Forumi udhëheqës evropian për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim është më i madhi deri tash me 7.000 pjesëmarrës. Debatet, panelet dhe ngjarjet speciale në forum sigurojnë kontroll në sfidat më urgjente të zhvillimit me të cilat ballafaqohet bota dhe qasje të ndryshme për ballafaqim me të njëjtat.

Konsensusi i ri evropian për zhvillim paraqet kornizën e përbashkët gjithëpërfshirëse për bashkëpunim të zhvillimit evropian. Për herë të parë zbatohet plotësisht në të gjitha institucionet të Unionit Evropian dhe të gjitha vendet-anëtare, të cilat obligohen të punojnë së bashku.

Mënjanimi i varfërisë mbetet qëllimi primar i politikës zhvillimore evropiane. Plotësisht i integron dimensionet ekonomike, sociale dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm. Me ç'rast, ajo e harmonizon aksionin zhvillimor evropian me Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm 2030, e cila gjithashtu është dimension ndërmjet sektorëve për Strategjinë globale të UE-së.

Liderët evropian janë përkushtuar në tre sfera:

1. Njohje të lidhjeve të forta të ndërsjella ndërmjet elementeve të ndryshme të cilat i përfshijn zhvillimin dhe paqen dhe sigurinë, ndihmën humanitare, migrimin, mjedisin jetësor dhe klimën, si dhe elementet ndër sektorë, siç janë: të rinjtë; barazi gjinore; mobilitet dhe migrim; Energji të qëndrueshme dhe ndryshime klimatike; Investime dhe tregti; Sundimi i mirë, demokracia, sundimi i drejtësisë dhe të drejtave të njeriut; Angazhim inovativ me

vendet më përparimtare në zhvillim; dhe mobilizim dhe shfrytëzim të resurseve të vendit.

2. Konsensusi i ri ndërmerr kalime gjithëpërfshirëse ndaj mjeteve për zbatim, duke e kombinuar ndihmën tradicionale të zhvillimit me resurse të tjera, si dhe politika të forta dhe qasje të përforcuar ndaj koherencës të politikave, duke përkujtuar se bashkëpunimi për zhvillim të UE-së kurdoherë duhet të shikohet në kontekst të Përpjekjeve personale të vendeve-partnere në Evropë. Konsensusi siguron bazë për UE-në dhe për vendet-anëtare të saja të përfshihen në forma më inovative të financimit për zhvillim, duke i zgjedhur investimet në sektorin privat dhe mobilizim të resurseve plotësuese të vendit për zhvillim.

3. Unioni Evropian dhe vendet-anëtare të saja do të krijojnë partneritete më të mira me spektër më të gjerë të palëve të prekura, duke përfshirë edhe shoqërinë qytetare dhe vendet-partnere në të gjitha fazat të zhvillimit. Ato mandej do ta përmirësojnë implementimin e tyre në teren, duke punuar më mirë së bashku dhe duke i marrë parasysh përparësitë e tyre adekuate të krahasimit.

Më 22 nëntor 2016, Komisioni Evropian i vazhdoi idetë e veta për qasje strategjike për arritje të zhvillimit të qëndrueshëm në Evropë dhe botë, duke përfshirë edhe propozim të Komisionit për konsensus të ri.

Parlamenti Evropian, Këshilli nën kryesimin të Maltës me UE-në dhe Komisioni u përfshinë në sesion intensiv të bisedimeve ndërinstitucionale të drejtuara kah kontraktimi për vizionin e ri kolektiv për politikë zhvillimore e cila i konvenon Agjendës 2030 dhe sfida të tjera globale.

<https://www.eudevdays.eu/>

eudevdays.eu

## FILLUAN BISEDIMET PËR “BREGZIT”



Britania e Madhe më 19 qershor i fillojë bisedimet me partneret të UE-së për lëshim të Unionit. Së pari do të zhvillohen bisedime për shumën e mjeteve të cilat Londra duhet t'i kthejë para lëshimit të UE -së, për të drejtat e qytetarëve të Britanisë dhe qytetarëve të UE-së dhe kufiri i tyre i jashtëm ndërmjet Irlandës Veriore.

Ekipin e bisedimeve të UE-së do ta kryesojë Mishell Barnie, tashmë me muaj është përgatitur të fillojë me bisedime, por Britania e Madhe vononte edhe pse më 29 mars këtë vit oficalisht fillojë procesi i lëshimit të UE-së/ Ndërmjet kohe në Britaninë e Madhe u mbajtën zgjedhje të parakohshme në të cilat kryeministrea Tereza Mej e humbi shumicën në Parlament, që plotësisht ndikonte në problemet.

Megjithatë, siç theksoi Tereza Mej "edhe më tej janë të bindur se mund të arrihet marrëveshje e guximshme dhe ambicioze e cila do të jetë në interes të të gjithë Britanisë", transmetoi agjencia AP duke shtuar se Unioni Evropian dëshiron kompromis të mirë.

"Nëse në atë nuk arin, të dyja palët do të ballafaqohen me humbje", vlerësoi ministri austriak për punë të jashtme, Sebastijan Kurc.

Rrethi i dytë i bisedimeve ndërmjet Mishell Barnie dhe ministrit britanik për Bregzit, Dejvid Dejvis është i planifikuar për 17 korrik, ndërsa i tërë procesi duhet të jetë i përfunduar dhe i lejuar nga ana e parlamenteve deri në fund të marsit të vitit 2019. Procesi do të mund të jetë i vazhduar, nëse për atë pajtohen 27 vendet-anëtare të UE-së.

Bisedimet filluan pothuajse një vit pas

vendimit të Britanisë së Madhe për prononcim nga UE-ja, e miratuar në referendumin nga 23 qershori 2016.

Detyrimet financiare të Britanisë ndaj UE-së vlerësohen në më së paku 65 miliardë euro, por mund të jenë edhe më të mëdha deri më 100 miliardë.

Në llogari janë përfshirë edhe detyrimet britanike në buxhet për vitet 2014-2020, si dhe shpenzimet për anëtarësim të institucione, banka dhe fonde të UE-së. Ndërmjet shpenzimeve janë ato për shpërngulje të agjenci për barna dhe agjencia bankare të UE-së nga Britania.

Edhe më problematike është çështja për garanci për rreth 5 milionë njerëz - rreth 3 milionë qytetarë të UE-së të cilët jetojnë në Britani dhe pothuajse 2 milionë Britanik në Evropë. Ato dëshirojnë të dinë çfarë do të jetë ardhmëria pas Bregzitet, çka do të ndodhë me benificionet e tyre shëndetësore dhe pensionale, tatimet, punësimin dhe arsimin.

Përfaqësuesit ofical të UE-së si afat real për marrëveshje e caktuan tetorin ose më së voni nëntor 2018. Nëse deri atëherë nuk arrihet marrëveshje, të dyja palët pa dyshim do të duhet të bëjnë marrëveshje kalimtare, që mund të shkaktojë edhe zgjerim të disa elementeve të lidhjes së deritashme.

<http://www.france24.com>

## TAKIMI I KËSHILLIT EVROPIAN

Në takimin e mbajtur më 22 dhe 23 qershor këtë vit, Këshilli Evropian fokusohet në: sigurinë dhe mbrojtjen, punët të jashtme, ndryshimet klimatike, ekonominë, tregtinë dhe migrimin.

Liderët të UE-së fortë i gjykan sulmet të paradokshme terroriste dhe e riafirmuan angazhimin e vet për bashkëpunim për:

- luftë kundër onlajn radikalizmit,
- parandalim të dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm,
- ballafaqim me financimin e terrorizmit,
- përmirësimi i këmbimit të informatave dhe interoperabilitetit të bazave të të dhënave.

Këshilli Evropian, dha pëlqim për nevojën nga fillimi i bashkëpunimit i përhershëm inkluziv dhe ambicion i strukturuar (PESCO) për përfundim të sigurisë dhe mbrojtjes të Evropës. Me qëllim ta fillojnë këtë bashkëpunim, vendet-anëtare në afat prej tre muaj do të duhet ta kontraktjnë listën e përbashkët të kriterëve dhe detyrimeve me projekte konkrete të arsyeshme.

Këshilli Evropian e përshëndeti komunikimin e Komisionit Evropian, për Fondin Evropian për mbrojtje dhe pret operacionalizim të tij të shpejtë. Liderët ftuan në marrëveshje të shpejtë për propozimin për Program Evropian për zhvillim industrial të mbrojtjes.

Shefat të shteteve dhe qeverive e dëshmuan vendosmërinë të UE-së dhe implementimin të plotë të Marrëveshjes së Parisit për ndryshime klimatike, duke i përfshirë qëllimet për financim klimatik dhe tranzitim global ndaj energjisë së pastër.

Liderët të vendeve-anëtare UE 27 u takuan që t'i shqyrtojnë ndodhitë e fundit në bisedimet pas njoftimit të Mbretërisë së Bashkuar sipas nenit 50 të Marrëveshjes për UE-në.

Në margjinat të takimit, liderët e përkrahën procedurën për rivendosje të agjencive të UE-së të cilat për momentin janë të vendosura në Britaninë e Madhe.

Liderët e vërtetuan përkushtimin e tregtisë të lirë dhe investimeve. Këshilli Evropian i ftoi ligjvënësit të kontraktohen për instrumentet për mbrojtje tregtare, kompatibilitet me STO për ballafaqim me dërgesa tregtare jofer.

Liderët ftuan në aktivitete konkret me të ciklat do të sigurohet bazë e fortë dhe konkurrenca industriale për tregun e vetëm, në bazë të konkluzioneve të Këshillit në maj të vitit 2017. Gjithashtu, i jepet kurajë Këshillit dhe Parlamentit Evropian për arritje të marrëveshje të mirë për zgjerim dhe përfundim të Fondit Evropian për investime strategjike.

Këshilli Evropian ftoi në aktivitete të mëtejme për ndërprerje të qarkullimit të migrimit nga Libia në Itali, përtej rrugës së mesme të mediteranit. Veçanërisht, fokusohet në:

- sigurim të trajnimit të mëtejme dhe pajisje për rojtarët Libian të bregut,
- bashkëpunim më i afërt me vendet të prejardhjes dhe transit,
- përpjekje të mëtejme për zmadhim të readmisionit.


Në takimin, gjithashtu u theksua nevoja nga vendosja urgjente e marrëveshjes për readmision me vendet të cilat nuk janë anëtare të UE-së dhe nevojën për reformë të sistemit të përbashkët për azil.

<http://www.consilium.europa.eu>



European Council

## UNIONI EVROPIAN I ANULOJË SHPENZIMET PËR ROAMING



Nga 15 qershori 2017 qytetarët të UE-së nuk ka të paguajnë shpenzime plotësuese për shfrytëzim të roaming shërbimet në territorin e Unionit Evropian.

Prej tash qytetarët të cilit do të udhëtojnë prej një vendi në tjetër, në korniza të UE-së, do të jenë në mundësi të realizohen kontakte telefonike, të dërgojnë sms porosi ose t'i lidhin celularët e tyre në internet me çmimin e njëjtë siç i paguajnë shërbimet e njëjta në vendet e veta.

Paraprakisht, operatorët ndërkombëtar mobil të UE-së paguanin një ri nga tjetri tarifa të mëdha, që në praktik do të thoshte se çdo evropjan doemos duhej të paguaj shpenzime plotësuese për shfrytëzim të shërbimeve për celular në roaming. E gjithë ajo rezultonte me llogari më të mëdha të telefonisë celulare pas kthimit në shtëpi.

Pas dhjetë vite bisedime dhe debate në nivel të UE-së, gjatë Kryesimit të Maltës me Këshillin e UE-së u mbyll kjo çështje që paraqet hap i rëndësishëm kah Tregu i vetëm digjital i UE-së.

Me mekanizmin "lëviz si në shtëpi", Parlamenti Evropian dhe Këshilli kërkuan nga Komisioni të zhvillojë numër të madh të masave për përkrahje ky mekanizëm të ringjallet në praktikë. Ajo solli në propozim ligjor për reformë të plotë të roaming tregut deri më 15 qershor 2016 dhe përcaktim të çmimeve maksimale të cilat operatorët mund t'i paguajnë ndërmjet veti për shfrytëzim zë rrjeteve të tyre nga roaming konsumatorët.

Në të njëjtën kohë, UE arriti të gjejë balancë të vërtetë ndërmjet fundit të shpenzimeve për roaming dhe nevojën

që të krijohet tregu i vendit për telefoninë celulare konkurrent dhe atraktiv.

Operatorët kanë afat prej dy vjet të përgatiten për këtë hap. Unioni Evropian është i bindur se operatorët do t'i shfrytëzojnë mundësitë të cilat i ofrojnë rregullat të reja për lojë në dobi të klientëve të tyre.

Fundi i shpenzimeve për roaming është baza e Tregut të vetëm digjital të UE-së dhe edhe një hap ndaj ndërtimit të shoqërisë evropiane digjitale të bashkuar dhe të qëndrueshme, e kapshme për të gjithë qytetarët e UE-së.

Përveç në 28 vendet-anëtare të UE-së, kjo politikë e "roaming pa shpenzime" do të zbatohet edhe në tre shtete të Fushës ekonomike të vendeve evropiane edhe atë, Norvegji, Lihtenshtajn dhe Islandë.

Megjithatë, shfrytëzuesit të shërbimeve të telefonisë celulare duhet të jenë të kujdesshëm dhe mirë ta lexojnë kontratën nga operatorët të telekomunikimeve para të njëjtin ta nënshkruajnë, sepse bisedat mund të jenë të shtrenjta. Shumica të konsumatorëve evropian kanë lidhur marrëveshje me ndonjë kompani të telekomunikimeve për shfrytëzim të pakufizuar të të ashtuquajturve fletreit, për shumë të caktuar të parave. Shumë është e sigurt se rregullat e reja do të jenë të përfshira në këto marrëveshje, veçanërisht kur bëhet fjalë për internetin për celularë.

<http://europa.eu>

## ËSHTE NËNSHKRUAR KONVENTA E STAMBOLLIT PËR LUFTË KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE

Në 13 qershor, Unioni Evropian e nënshkroi Konventën të Stambollit - Konventë e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës mbi grat dhe dhunës familjare (prej 11.05.2011).

Nënshkrimi i Konventës konsiderohet për marrëveshje historike e iniciuar në ftesë të përbashkët nga tre institucione evropiane. Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian dhe Kryesimi i Maltës me Këshillin e UE-së.

Agjencia Evropiane për të drejta fundamentale, pas hulumtimit të bërë në më shumë se 42.000 gra, shpalli se 1/3 të grave në Unionin Evropian janë viktima të dhunës gjinore gjatë kohës së jetës të tyre dhe kjo formë e dhunës është gjerë e përhapur në të gjitha vendet të Unionit.

Kryesimi i Maltës me Këshillin e UE-së më 03 shkurt këtë viti mbajti konferencë në bashkëpunim me Komisionin Evropian, me qëllim ngritje të vetëdijes për nevojën nga zgjedhja e kësaj forme të dhunës, për ratifikimin kombëtar të Konventës së Stambollit, dhe për arritje të marrëveshje në nivel të Këshillit të UE-së.

Nënshkrimi i kësaj konvente nga ana e UE-së dërgon sinjal të fortë politik deri te të gjithë 28 shtetet-anëtare për rëndësinë e

Konventës, për rëndësinë nga pranimi dhe zbatimi i standardeve në lidhje me luftën kundër dhunës te gratë dhe dhunës familjare.

Ambasadori Xhozef Fileti përfaqësues i përhershëm i Maltës në Këshillin e Evropës - në emër të Kryesimit të Maltës me Këshillin e UE-së, dhe komisarit evropian përgjegjës për drejtësi, konsumatorë dhe barazi Vera Jourova në emër të Unionit Evropian, e nënshkroi Konventën e Stambollit.

Deri tash Konventën e Stambollit e kanë ratifikuar 23 vende, duke përfshirë edhe 14 vende-anëtare të UE-së.

Republika e Maqedonisë e nënshkroi Konventën më 08.07.2011 por ende nuk e ka ratifikuar. Ratifikimi i konventës nënkupton një sërë detyrimesh për qeveritë kombëtare të cilat e kanë ratifikuar të ndërmarrin hapa konkrete për parandalim të të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

<https://www.eu2017.mt/en/>

<https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home>



### UE KALENDAR /korrik 2017

1. Estonia e ndërmerr Kryesimin me Këshillin e UE-së - 01 qershor 2017;
2. Sesion plenar i Parlamentit Evropian, 03-06/07/2017, Strasburg;
3. Dita ndërkombëtare e hepatitit, 28/07/2017 Stokholm, Suedi.

**European Union**  
Newsroom

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home
Highlights
Press releases
Calendar
Audiovisual
Press contacts
Press facilities
About the EU

### CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

July

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					



## KUVENDIN I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

### UE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: [nsei@sobranie.mk](mailto:nsei@sobranie.mk)

Zyra 019

Zyra për përkrahje të Këshillit kombëtar për  
euorintegritime

---

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

---

*Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.*

*Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendre në Kuvend.*

*Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me UE çështjet.*

